



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE**

RELACION SHPJEGUES

**1. LISTË PËRMBAJTJE E RAPORTEVE TË MONITORIMIT PËR PERIUdhËN
JANAR DHJETOR 2025**

- ANEKSI nr 1.2 “Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor”
- ANEKSI nr.2 “Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit”
- ANEKSI nr.2.1 “Shpenzimet e Programit sipas kapitujve”
- ANEKSI nr.3 “Raporti I performances së produkteve të programit”
- ANEKSI nr.3.1 “Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve”
- ANEKSI nr.3.2 “Devijacioni I kostos për njësi në vite”
- ANEKSI nr.4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës të programit”
-

2. HYRJE

Në zbatim të Shtojcës nr.3, të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të kryer gjatë periudhës Janar Dhjetor 2025, si në vijim:

Programi Shërbimet për çështjet e birësimeve në përmbushje të politikës së programit të vet ka kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, Ligjin nr.115/2024, , “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe udhëzimet plotësuese të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në zbatim të tij.

EMP me në krye DEMP ka realizuar në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e performancës së programit, konkretisht të politikës së programit, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në funksion të saj për të gjithë artikujt kontabël përkatës. Paralelisht është bërë edhe monitorimi i buxhetit dhe nivelit të shpenzimeve në përputhje me produktet e realizuara.

3. INFORMACION BUXHETORI I AGREGUAR

Gjatë periudhës raportuese, në zbatim të , Ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025” në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.2, dt.24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, dhe Udhëzimi plotësues Nr.2/1, dt.11.07.2025 Një shtesë në udhëzimin nr 2 datë 24.01.2025“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” janë rialokuar fonde buxhetore brenda programit. Konkretisht:

a. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 1060/1 prot., datë 07.04.2025, “Transferimi i fondit për vitin 2025”, vlera prej 24.000 lekësh u pakësua nga llogaria ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) dhe u shtua në llogarinë ekonomike 606 (Transferita për buxhete familjare dhe individë). Këto fonde, sipas pikës 14 të VKM nr. 673/2020, përdoren për kompensimin e titullarit të institucionit për shërbimin e telefonisë celulare.

b. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 1059/3 prot., datë 12.03.2025, “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë dhe ndryshimi i planit të limitit për vitin 2025”, për institucionin tonë është miratuar detajimi i buxhetit për fondin e veçantë në vlerën 100.000 lekë për vitin 2025.

c. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 911 prot., datë 11.02.2025, “Dërgohet detajimi i limitit mujor për vitin 2025”, si dhe shkresën Nr. 1060/2 prot., datë 17.04.2025, “Dërgohet miratimi i shpenzimeve kapitale 2025–2027 dhe transferimi i fondit për vitin 2025”, për institucionet në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe për institucionin tonë është miratuar zbatimi i projektit 18AR302 “Blerje pajisje zyre”, në vlerën 200.000 lekë për vitin 2025.

Numri I punonjësve sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri nr.134 Prot. datë 23.11.2021 dhe strukturës së fundit të miratuar nga Kryeministri me kategoritë e ndryshuara nr.227 Prot. datë 15.12.2023, për Insitucionin tonë, për periudhën Janar Dhjetor 2025 është 9 punonjës së bashku me Kryetarin e KSHB. Në total bashkë me punonjësit mbështetës bëhen 12 punonjës. Për periudhën 1 Nëntor 2024 deri 30 Shtator 2025, pozicioni I Specialistes (Buxhet-Finance) me kategori page IV-2, ka qënë vakant. Gjithashtu pozicioni i Specialist (Jurist) – me kategori page IV-2 me datë 02 Maj 2025 ka qënë vakant, (specialist jurist larguar me dëshirë) pozicioni vakant është plotësuar me transferim të përkohshëm te Punonjësës Anxhela Bakalli nga Specialist arkivë protokoll ne Specialist Jurist nga periudha 28 Maj 2025 deri me 10 Dhjetor 2025. Nga 11 Dhjetori 2025 deri me 31 Dhjetor 2025 pozicioni Specialist Jurist ishte vakant mbarim transferimi i përkohshëm. Ne 30 Janar te 2025 nga Programi Thirrja e IX e praktikave te punës eshte punësuar me kontrat 1 vjecare “Specialist pranë arkivë

protokollit” Znj. Ilda Keci punonjësja ka marre lejelindje , të paguar nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për periudhën 10 Korrik 2025- 31 Dhjetor 2025 në vazhdim.

4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025 është monitoruar vazhdimisht buxheti i miratuar dhe në zbatim të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.2, dt.24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, dhe Udhëzimi plotësues Nr.2/1, dt.11.07.2025 Një shtesë në udhëzimin nr 2 datë 24.01.2025“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, me kërkesë të KSHB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratoi rialokimin e shumës prej 24.000 lekë nga artikulli 602 (Mallra dhe shërbime) në artikullin 606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë). Nga ana tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar fondin e veçantë prej 100.000 lekë për vitin 2025.

Realizimi i buxhetit të institucionit, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, është 80%. Plani fillestar vjetor i programit për vitin 2025 ka qenë 18,640,000 lekë; gjatë vitit janë miratuar ndryshime buxhetore neto në vlerën 100,000 lekë, duke e çuar planin vjetor të rishikuar në 18,740,000 lekë. Realizimi faktik për periudhën Janar–Dhjetor 2025 është 14,961,916 lekë, me një devijim prej 3,778,084 lekë nën planin e rishikuar.Devijimi prej 20% ndaj planit lidhet kryesisht me nënrealizimin në artikujt 600 dhe 601 (si pasojë e pozicioneve vakante), në artikullin 602 (mosrealizimi i plotë i procedurave të prokurimit), si dhe në artikullin 231 (realizim i pjesshëm i investimit të planifikuar). Ky devijim nuk ka ndikuar negativisht në përmbushjen e objektivave dhe produkteve të programit.

Në Aneksin nr.2 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas produkteve të programit buxhetor si më poshtë

Emri i Grupi		Ministria e Drejtësisë		Kodi i grupit		14						
Emri i		Shërbimet për Çështjet e Biresimeve		Kodi i programit		01160						
EMËRTIME		Shpenzimet e Programit										
		Ytiti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndrgshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %	Ndrgshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Kodi i Programit	Emërtimi											
600	Paga	11,558,125	58	12,820,000	58	12,820,000	58	0	10907893	85	1,912,107	85
601	Sigurime Shoqërore	1,889,981	56	2,180,000	56	2,180,000	56	0	1768526	81	411,474	81
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,746,010	45	3,440,000	45	3,416,000	45	-24,000	2174241	64	1,241,753	64
603	Subvencione	0.0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0.0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0.0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans për Bush. Fam. & Individ	149,000	77	0	77	124,000	77	124,000	24,872	20	99,128	20
	Nëntotali Shpenzime Korente	16,343,116	55	18,440,000	55	18,540,000	55	100,000	14,875,532	80	3,664,468	80
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.0	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	197,472	43	200,000	43	200,000	43	0	86,384	43	113,616	43
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të bre	197,472.00	43	200,000	43	200,000	43	0	86,384	43	113,616	43
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	197,472.0	43	200,000	43	200,000	43	0	86,384	43	113,616	43
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	16,343,116.0	55	18,640,000	55	18,740,000	55	100,000	14,961,916	80	3,778,084	80
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0							0			
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0							0			
	Totali i Shpenzimeve të Programit	16,540,588.00							14,961,916			
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor												
Artikulli	Emërtimi											
	Totali i Shpenzimeve Korente	16,540,588.0	99	18,440,000	99	18,540,000	99	100,000	14,961,916	81	3,778,084	81
Kodi i produktit	Emërtimi											
91404AA	Kërkesa për birësim të shqyrtuara	16,540,588	99	18,440,000	99	18,540,000	99	100,000	14,961,916	81	3,578,084	81
	Totali Shpenzime për Investime	197,472	1	200,000	1	200,000	1	0	86,384	43	113,616	43
Kodi i produktit	Emërtimi											
18AR302	Pajisje elektronike të blera	0	1	200,000	1	200,000	1	0	86,384	1	113,616	43
M140033	Pajisje për zyra	197,472	1	0	0	0	0	0	0	0	0	43
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	197,472	1	200,000	1	200,000	1	0	86,384	1	113,616	43
Kodi i produktit	Emërtimi											
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kodi i produktit	Emërtimi											
Kodi i produktit	Emërtimi											
	Totali i Shpenzimeve të Programit	16,540,588		18,640,000		18,740,000		100,000	14,961,916		3,778,084	

Në Aneksin nr.2/1 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi buxhetor dhe realizimi i artikujve buxhetore në përqindje si më poshtë :

RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese Periodike /Vjetore	Buxheti	Artikujt buxhetore									Total
							230	231	600	601	602	603	604	605	606	
							Shpenzime Kapitale të Patrupezuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveçinet	Te Tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transferita për Buxhetet Familjare dhe Individët	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	0	200,000	12,820,000	2,180,000	3,440,000	0	0	0	0	18,640,000
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	0	200,000	12,820,000	2,180,000	3,416,000	0	0	0	124,000	18,740,000
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	0	86,384	10,907,891	1,768,526	2,521,896	0	0	0	69,872	15,354,570
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2025	Plani fillestar	0	200,000	12,820,000	2,180,000	3,440,000	0	0	0	0	18,640,000
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2025	Plani i rishikuar	0	200,000	12,820,000	2,180,000	3,416,000	0	0	0	124,000	18,740,000
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2025	Fakti	0	86,384	10,907,893	1,768,526	2,174,241	0	0	0	24,872	14,961,916
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Ndryshimi ne vlere absolute			2025		0	113,616	1,912,107	411,474	1,241,759	0	0	0	99,128	3,778,084
14	01160	Realizimi ne %			2025		0	43	85	81	74	0	0	0	56	82

Diferencat në realizim në llogarinë ekonomike 600 (Paga) dhe 601 (Sigurime shoqërore) ka lindur si rrjedhojë e pozicionit vakant të Specialistes (Buxhet- Finance), e cila është plotësuar ne 30 Shtator 2025 dhe pozicioni i Specialist (Jurist) – ka qënë i paplotësuar përfundimisht gjithashtu edhe se punonjësja me kontratë të përkohëshme ka qënë me raport paaftësie, të paguar nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Për llogaritë ekonomike 600–601 “Shpenzimet e personelit”, fondet buxhetore janë realizuar përkatësisht në masën 85% dhe 81% për periudhën 12-mujore, krahasuar me planin vjetor të rishikuar. Për artikullin 600 (Paga), plani vjetor është 12,820,000 lekë, ndërsa realizimi faktik 10,907,893 lekë, me devijim 1,912,107 lekë (15% nën plan). Për artikullin 601 (Sigurime Shoqërore), plani vjetor është 2,180,000 lekë, ndërsa realizimi 1,768,526 lekë, me devijim 411,474 lekë (19% nën plan). Nënrealizimi lidhet me mosplotësimin e plotë të strukturës organike dhe përfitimet e paguara nga ISSH për periudhat e lejes së lindjes. Për vitin pasardhës rekomandohet planifikim më realist, i harmonizuar me numrin faktik të personelit.

Sa i takon llogarisë ekonomike 602 “Mallra dhe Shërbime të Tjera”, realizimi për periudhën 12-mujore është 64%. Planin vjetor i rishikuar është 3,416,000 lekë, ndërsa realizimi faktik 2,174,241 lekë, me devijim 1,241,759 lekë (36% nën plan). Diferenca ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të plotë të procedurave të planifikuara të prokurimit gjatë vitit buxhetor. Nënrealizimi nuk ka cenuar funksionimin e institucionit, por evidenton nevojën për përmirësim të planifikimit dhe ndjekjes së afateve procedurale në vitin pasardhës.

Për llogarinë ekonomike 606 “Transferta për buxhete familjare dhe individë”, plani vjetor i rishikuar është 124,000 lekë, ndërsa realizimi faktik 24,872 lekë, me devijim 99,128 lekë (80% nën plan) dhe nivel realizimi 20%. Nënrealizimi lidhet me përdorimin faktik të kufizuar të fondit dhe mosshfrytëzimin e plotë të shumës së planifikuar.

Për llogarinë ekonomike 231 “Shpenzime kapitale”, plani vjetor është 200,000 lekë, ndërsa realizimi 86,384 lekë, me nivel realizimi 43% dhe devijim 113,616 lekë (57% nën plan). Devijimi lidhet me realizimin e pjesshëm të investimit të planifikuar për pajisje elektronike; pjesa e përealizuar do të rishikohet në planifikimin e vitit pasardhshëm në funksion të nevojave reale të institucionit.

Në total, për periudhën 12-mujore të vitit 2025, shpenzimet buxhetore të programit janë realizuar në masën 80%, me plan vjetor të rishikuar 18,740,000 lekë dhe realizim faktik 14,961,916 lekë, duke rezultuar në devijim 3,778,084 lekë nën plan.

Numri I lartë I fëmijëve të birësuar vjen si pasojë :Rritjes së numrit të fëmijëve të braktisur te shpallur me Vendim Gjykate dhe birësimeve me pëlqim (ose me lidhje gjaku).

Konkretisht numri I fëmijëve ne KSHB lidhet drejtpërdrejt me numrin e dosjeve të depozituara. Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2025 është 28 fëmijë, nga të cilat janë mbartur edhe dosjet e fëmijëve të ardhur nga vitet e mëparshme dhe jane birësuar 26 fëmijë

Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2024 është 17 fëmijë nga te cilet jane birësuar 12 fëmijë

Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2023 është 24 fëmijë nga te cilet jane birësuar 22 fëmijë

Për vitin 2025, deri në fund të 12-mujorit, janë birësuar 26 fëmije.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

***Qëllimi** – Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykate, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.*

Në vlerësimin e regresve të performancës, qëllimi konsiderohet i realizuar.

Në realizimin e plotë të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetësuese për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur dy objektiva për realizim, si më poshtë:

1. **Objekti 1.1** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja, të 26 fëmijëve gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025. **Ky objektiv është përmbushur plotësisht.** Gjatë periudhës raportuese, KSHB ka shqyrtuar brenda afateve ligjore të gjitha kërkesat për birësim.
2. **Objekti 1.2** – Pajisje elektronike të blera. **Ky objektiv është në proces realizimi.** Është kryer procedura për “Blerje Pajisje elektronike” si dhe janë marrë në dorëzim - konkretisht u ble një kompjuter PC Lenovo.

Sipas Anekseve nr.3 Raporti I performances së produkteve të programit dhe nr.3/1 Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve si më poshtë :

ANEKSI nr.3 Raporti i performancës së produkteve të programit

Periodha e Raportimit 12-2025

në lekë

Emri i Grupit		Ministria e Drejtësisë		Kodi i grupit		14											
Emri i		Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Kodi i programit		01160											
Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Njësia matëse	Viti paraardhës			Periodha Raportuese			Periodha Raportuese			Periodha Raportuese			Deviacioni i Kostos per Njesi		
			Sasia Faktike (Viti paraardhës)	Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës)	Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor)	Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor)	Kosto për Njësi (sipas planit Fillestar të vitit)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Sasia Faktike (në /nfund të vitit korent)	Shpenzimet Faktike (në /nfund të vitit korent)	Kosto për Njësi Faktike (në /nfund të vitit korent)	13=(12)-(3)	14=(12)-(6)	15=(12)-(9)
			(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)
Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të																	
91404AA	Kërkesa per birësim të shqyrtuara	Numer	12	16,343,116	1,361,926	20	18,440,000	922,000	20	18,540,000	927,000	26	14,875,532	572,136	-789,790	-349,864	-354,864
18AR302	Pajisje elektronike të blera	Numër				2	100,000	50,000	4	200,000	50,000	1	86,384	86,384	86,384	36,384	36,384
M140033	Pajsje per zyra	Numer	2	197,472	98,736	2	100,000	50,000							-98,736	-50,000	-98,736
T	Total			16,540,588			18,640,000			18,740,000			14,961,916				
Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06)																	

Aneksi 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve

Periodha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Tipi i Buxhetit	Sasia	Artikujt buxhetore										
							Total	230	231	600	601	602	603	604	605	606	
								Shpenzime Kapitale të Patruëzuarra	Shpenzime Kapitale të Trupëzuarra	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveçnet	Te Tjera Transfer Korrente Brendshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transfera për Buxhetet Familjare dhe Individët	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	91404AA	Kërkesa për birësim të	Plani fillestar	20	18,440,000	0	0	12,820,000	2,180,000	3,440,000	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	91404AA	Kërkesa për birësim të	Plani i rishikuar	20	18,540,000	0	0	12,820,000	2,180,000	3,416,000	0	0	0	124,000	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	91404AA	Kërkesa për birësim të	Fakti	9	14,875,532	0	0	10,907,893	1,768,526	2,174,241	0	0	0	24,872	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	18AR302	Pajisje elektronike të	Plani fillestar	2	200,000	0	200,000	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	18AR302	Pajisje elektronike të	Plani i rishikuar	2	200,000	0	200,000	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	18AR303	Pajisje elektronike të	Fakti	1	86,384	0	86,384	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	M140032	Pajsje per zyra	Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	M140033	Pajsje per zyra	Plani i rishikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	M140034	Pajsje per zyra	Fakti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
				Totali i shpenzime buxhetore	Plani fillestar		18,440,000	0	200,000	12,820,000	2,180,000	3,440,000	0	0	0	0	0
				Totali i shpenzime buxhetore	Plani i rishikuar		18,740,000	0	200,000	12,820,000	2,180,000	3,416,000	0	0	0	124,000	0
				Totali i shpenzime buxhetore	Fakti		14,961,916	0	86,384	10,907,893	1,768,526	2,174,241	0	0	0	24,872	0

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objekt, situata paraqitet si në vijim:

Objekti 1.1 Ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti 91404AA – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. *Ky produkt është përmbushur në masën 130 % krahasuar me planin .*

Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor) 20

Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2025) 26

Megjithëse realizimi financiar i përgjithshëm është 80%, realizimi fizik i produktit kryesor (kërkesa për birësim të shqyrtuara) ka arritur në 130% të planit, çka tregon eficiencë në përdorimin e burimeve buxhetore dhe optimizim të shpenzimeve në raport me performancën e arritur.

Objekti 1.2 – Pajisje elektronike të blera. Ka patur një produkt të parashikuar.

Produkti 18AR302 – Pajisje elektronike të blera. *Për këtë produkt është kryer procedura e prokurimit. Ky produkt është realizuar 43% krahasuar me planin.*

Birësimet gjate 2025 janë 26 në total nga të cilat janë mbartur edhe femijët e ardhur nga vitet e mëparshme. Pë vitin 2024 janë birësuar 12 femijë .Për vitin 2023 janë birësuar 22 femijë.

Qëllimi i KSHB: Bazuar në treguesit e realizimit të objektivave dhe produkteve të programit, qëllimi strategjik i programit konsiderohet i realizuar, pasi janë trajtuar të gjitha kërkesat e paraqitura dhe janë përfunduar procedurat për 26 femijë brenda afateve ligjore. duke përjashtuar rastet kur femijët janë me probleme shëndetsore.

Shpenzimet për këto produkte janë planifikuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit në fillim të vitit 2025. Të gjitha procedurat e birësimit të realizuara brenda dhe jashtë vendit kanë rezultuar të sukseshme dhe përshtatja prind-fëmijë është arritur plotësisht. Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektiv janë realizuar.

Në përfundim të analizës së realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve të programit, mund të themi se gjatë periudhës Janar Dhjetor 2025, KSHB ka bërë një punë mjaft të mirë për përmbushjen e politikës së programit të vet. Institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur plotësisht qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, dhe realizimi i proceseve birësuese për të gjithë femijët dosjet e të cilëve janë depozituar ne KSHB, duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të femijëve.

Theksojmë se, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025 për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fondet nga Buxheti i Shtetit.

5. PROJEKTET KAPITALE

Sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar projekte të mëdha investimi kapitale me financim të brendshëm apo të huaj gjatë vitit 2025. Gjatë periudhës raportuese është parashikuar dhe realizuar vetëm një investim kapital me vlerë të kufizuar, i lidhur me blerjen e pajisjeve elektronike (artikulli 231), sipas planifikimit buxhetor vjetor. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe, për rrjedhojë, nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025.

6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 1059/3 prot., datë 12.03.2025, “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë dhe ndryshimi i planit të limitit për vitin 2025”, për institucionin tonë është miratuar detajimi i buxhetit për fondin e veçantë prej 100.000 lekë. Gjithsej janë shtuar fonde prej 100.000 lekësh, në llogarinë si vijon :

- Për llogarinë ekonomike 606: 100.000 lekë

Ndryshimet e buxhetit(shtesat) paraqiten për periudhën raportuese në formë tabele,sipas llogarive ekonomike si në vijim:

Përshkrimi	Totali	Llog. 600	Llog. 601	Llog. 602	Llog. 606	Llog. 231
Buxheti (Plan)	18,640,000	12,820,000	2,180,000	3,440,000	0	200,000
Buxheti (shtesat në plan)	100,000	0	0	-24,000	124,000	0
Ndryshimet në buxhet (Plani i rishikuar)	18,740,000	12,820,000	2,180,000	3,416,000	124,000	200,000
Plan thesari 12-mujor	18,740,000	12,820,000	2,180,000	3,416,000	124,000	200,000
Realizimi fakt	14,961,916	10,907,893	1,768,526	2,174,241	24,872	86,384

Realizimi i buxhetit të Institucionit tonë për periudhën Janar- Dhjetor 2025 është **14,961,916** lekë, krahasuar me buxhetin total të vitit **18,740,000** lekë Niveli i realizimit përfaqëson 80% të planit vjetor, me një diferencë prej 3,778,084 lekë nën plan.

7. PËRFUNDIME

Gjatë periudhës raportuese nuk janë evidentuar risqe buxhetore që cenojnë realizimin e programit. Risqet kryesore të identifikuar lidhen me vakancat në strukturën e personelit dhe vonesat procedurale në prokurime, për të cilat janë marrë masa organizative për minimizimin e tyre në vitin pasardhës. Të ardhurat sekondare të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025 nuk janë përdorur si burim financimi për shpenzime, por janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit. Të ardhurat e Institucionit tonë për periudhën 12-mujore janë 498,853.20 lekë. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025, institucioni ynë, në kuadër të monitorimit të buxhetit, ka përgatitur në Evidencën e shpenzimeve. përkatëse.

Ky raport publikohet ne <https://kshb.gov.al/transparenc/> rubrika Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të KSHB

HARTOI:
SPECIALIST (BUXHET - FINANCË)

Marcela Kocaj



- 10 -

